

Zhvillohet analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit

Më datë 6 shkurt 2023, në mjediset e KLSH u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit (DABSH), e cila u fokusua në prezantimin e rezultateve të Departamentit për vitin 2022, problematikat e shfaqura, si dhe sfidat për të ardhmen.

Drejtori i Departamentit z. Gjovalin Preçi, paraqiti raportin mbi veprimtarinë e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2022 si dhe objektivat e synimet për këtë vit.

Gjatë vitit 2022, nga 19 auditimet e planifikuara, prej të cilëve 2 auditime tematike për zbatimin e rekomandimeve, DABSH ka realizuar 18 auditime, ku janë audituar më shumë subjekte sesa planifikimi, pasi tre Drejtori të Përgjithshme në MFE janë audituar të bashkuara. Gjatë prezantimit u theksua fakti se një numër i konsiderueshëm subjektesh të audituara kanë shfaqur mangësi në menaxhimin ekonomik dhe financiar të veprimtarisë tyre, me pasoja në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.



Gjatë diskutimeve të audituesve, u theksua nevoja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së auditimeve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë që në procesin e hartimit të programit të auditimit, dokumenteve të raportimit të auditimit në mënyrë që të jenë të plota, të sakta, objektive, të bindshme, të qarta, koncize dhe me një pamje të përshtatshme dhe të kuptueshme për subjektet, parlamentarët, opinionin publik etj. Në kuadër të raportimit, një angazhim serioz do t'i kushtohet unifikimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të cilat kanë tipologji të njëjtë, në subjekte të ndryshme, si dhe formulimit dhe klasifikimit të saktë të gjetjes dhe rekomandimit në funksion të rritjes së veprimtarisë audituese të KLSH.



Në përfundim, krahas objektivave për realizimin e programit të auditimeve, përmirësimit të cilësisë së auditimeve, përpjekjeve maksimale për zbatimin sa më të plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-t) etj., u paraqitën synimet për të ardhmen:

1. Rritja e impaktit të veprimtarisë audituese të Departamentit, duke konsoliduar auditimin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, si dhe duke kryer auditime financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.
2. Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet përvetësimit të metodologjive dhe standardeve të aplikueshme në përputhje me praktikat më të mira, nxitjes dhe promovimit të vlerave të larta profesionale të audituesve, duke vënë integritetin si vlerë themelore.
3. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
4. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

I pranishëm në këtë analizë ishte Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve z. Bexhet Zeqiri, i cili bëri prezent problematikat e shfaqura në auditimet e evaduara në vitin 2022..